

## **Momu Group sh.p.k.**

### **AKT THEMELIMI**

#### **Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**

Sot, më datë 06/06/2024, në Tirane, Z. Jurgjen Nikola, shtetas Shqiptarë, me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i datëlindjes 19/05/1995, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal J50519078H dhe Z. Rafailito Nikola, shtetas Shqiptarë, me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i datëlindjes 23/12/1999, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal J91223056R nënshkruajnë këtë akt themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emër Momu Group.

#### **Neni 1**

##### **Forma e shoqërisë**

Ortakët themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në kuptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar deri në shumën e kapitalit të derdhur, pa iu njohur asnjë përgjegjësi tjetër.

#### **Neni 2**


##### **Emërtimi i shoqërisë**

Emërtimi i shoqërisë është Momu Group.

#### **Neni 3**

##### **Baza juridike**

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe në përputhje me dispozitat e statutit dhe aktit të themelimit të saj.



#### **Neni 4**

##### **Objekti i veprimtarisë**

4.1 Shoqëria Momu Group përcakton objektin e saj si më poshtë:

4.2 Import eksport të automjeteve dhe jo vetëm, tregtia dhe distribucioni i mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, shitje me shumicë dhe pakicë të veshjeve, shitblerje dhe dhën  
ie me qira  
e makinave. Veprimtari në fushën e konsulencës, investimeve, ndërtimit, turizmit si dhe  
çdo  
veprimtari tjetër të nevojshme për realizimin e qëllimit të shoqërisë që nuk bie ndesh me  
legjislacionin Shqiptarë në fuqi.

4.3 Shoqëria, me vendim të administratorit, mund të lidhe marrëveshje tregtare apo  
bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprimtari tre  
gtare që  
konsiderohet e nevojshme me qëllim arritjen e objektit të saj por gjithmonë duke i vë  
në ata në dijeni.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj, shoqëria mund të sigurojë dhe përdorë financime nga  
ortaket, nga vende të tjera si dhe nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet apo të kufizohet  
në bazë të vendimit të ortakëve.

#### **Neni 5**

##### **Selia**

Shoqëria Momu Group ka selinë në adresën:

Rrugën Asim Vokshi, Nd.10, Nr. Hyrje 2, Nr. Ap 3, Tiranë.

#### **Neni 6**

##### **Kohëzgjatja**



Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pa përcaktuar.

#### **Neni 7**

##### **Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1 000 (një mijë) lekë.

#### **Neni 8**

##### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë do te jete:

Z. Rafailito Nikola, person me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 23/12/1999, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal J91223056R. Afati i emërimit te administratorit do te jete për një periudhe 3 vjeçare nga data 06/06/2024 deri me date 05/06/2027.

#### **Neni 9**

##### **Viti financiar**

Vitet financiare përputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe do të mbyllet në fund të vitit përkatës.

#### **Neni 10**

Të ardhurat neto



Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë në raport me k  
uotat e tyre  
në kapital. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, në p  
ërputhje  
me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe rezervës së  
domosdoshme, të konkretizuara në pasqyrat dhe raportet financiare të çdo viti financiar,  
mund të  
ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë  
, ose mund të ri investohen si kapital i shoqërisë.

#### **Neni 11**

#### **Juridiksioni**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, do të  
zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre janë  
gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqërisë Momu Group me përgjegjësi të kufizuar është hartuar në 2  
(dy) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, nënshkruhet nga ortakët themelues.

#### **Ortakët e Shoqërisë Momu Group**

**Jurgen Nikola**



**Rafailito Nikola**

